REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 211/17
Datë/Datum. 10.07.2017
PRISHTINË PRIŠTINA

# ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: *MINISTRIA E ADMINISTRATES PUBLIKE*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(202/17/060/136)*

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me material për ID- kartela**

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit*

SOLVIT SHPK
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

*Rr. Iljaz Kora Q.T. Kroi i bardhe Nr. 105, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës*
*(Adresa)*

*Prishtinë* — *(Vendi)*

*10000* — *(Kodi postar)*

*+377* [redacted] — *(Numri Telefonit)*

*(Numri i Faks-it)*

*Ilirjan Miftari*
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

[redacted]
*(Adresa elektronike)*

*10.07.2017*
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

*(Nënshkrimi dhe vula)*

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA SOLVIT * Prishtinë *

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

*(Emri i avokatit)*

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po [X] Jo [ ]

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*
*Njoftimi për dhënje të kontratës është bërë me datë 20-Qershor-2017*
*Ne kemi dorëzuar kerkesën për rishqyritim te vendimin pranë AK me date 24-Qershor-2017*
*Peërgjigjeja lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyritim të vendimin pranë AK na është kthyer negativ me date 29-Qershor-2017*
*Bashkangjitur gjenden dokumentet e dërguara dhe pranuara*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Dosja e tenderit nuk është pergatitur në pajtim me ligjin e prokurimit public Ligji Nr. 04/L-042 sepse kërkesat për perzjgedhjen e OE fitues; kërkesa "Kompania duhet të ketë së paku një person të certifikuar për mirëmbajtjen e printerëve Zebra ZXP series 8" është dashur të vendoset si kriter te kërkesa "**III.4 KËRKESAT MBI MUNDËSITË TEKNIKE DHE/OSE PROFESIONALE**" dhe jo tek specifikimi teknik.

AK e ka vendosur kërkesen në vendin e gabuar në dosjen e tenderit

Duke pasur parasyshe aresyet e cekura me larte, konkludojme se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar ligjin e prokurmit publik, prandaj, në kete faze e vetmja zgjidhje është anulimi procedures se prokurimit, në pajtim me dispoziten **"një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në proceduren e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit"**

Ky lëshim ri-vertetohet edhe në faktin se në pyetjet sqaruese që kemi parasthruar ne rreth mirëmbajtjes se printerëve, AK është përgjigjur dhe ka ka potencuar se "Në plotësim e datës 22/05/2017 kemi specifikuar edhe Mirëmbajtje e Printerëve Zebra ZXP series 8." **Pra edhe në sqarim është dhënë si specifikë.**

Por edhe po të kualifikohej si specifikë e detyrueshme ashtu edhe si është renditur nga AK nën Aneksin 1 te DT, prapë nuk është plotësuar nga OE i shpallur fitues. **OE nuk ka sjellur dëshmi se do te mund ta plotësoj këtë kërkesë ende pa filluar kontrata. Duke sjellë dëshmi jo adekuate dhe jo relevante, në fakt ka dëshmuar se nuk mundësi për ta përmbushur kërkesën e mirëmbajtjes ku përfshihen riparimet dhe servisimet.**

**Shkelja e Parë:**

**AK ka shkelur dispozitat e ligjit të prokurimit publik "Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi"**

**Neni 7" i cili nder te tjera thotë:**

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

**Shkelja e dytë:**

**AK e ka shkelur nenin 59 të ligjit të prokurimit publik për vlerësim të tenderëve.**

**Neni 59, pika 4.0 ndër të tjera thotë:**

1. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pra, AK duhet ti vlerësoj ofertat-tenderët në bazë të kërkesave të vëna nëse dosje te tenderit dhe jo vetëm në njoftimin për kontratë.

Ne ju kemi përmbajte me saktësi kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit (të ri për kontratë) për përmirësimin e gabimit dhe i kemi plotësuar ato kërkesa, dhe për atë arsye çmimi ynë është real ashtu si është. Po të mos ishte kriter dosja e tenderit atëherë pse ju është dashur juve që të publikoni njoftimin për ndryshim apo për përmirësim të gabimit? Çfarë ka ndryshuar, nëse në fakt nuk është ndryshuar asgjë? Për çfarë arsye është dashur të bëhet vazhdimi i dorëzimit të ofertave nëse nuk ka pasur ndonjë gabim?

OE i përzgjedhur fitues nga AK ELTING-EL nuk e ka përmbushur kërkesën "Kompania duhet të ketë së paku një person të certifikuar për mirëmbajtjen e printerëve Zebra ZXP series 8" dhe dokumenti-Autorizimi nga një kompani Italiane e cila nuk ka juridiksion të lejuar nga prodhuesi për të lëshuar autorizime për territorin e Kosovës, nuk është relevant në këtë rast, nuk përmban emrin e stafit të certifikuar për mirëmbajtje, servisim apo riparim, prandaj operatori Ekonomik i përzgjedhur nga AK nuk është i përgjegjeshëm në këtë kërkesë.

Po ashtu OE i përzgjedhur fitues nga AK ELTING-EL nuk e ka permushur kërkesën e "Laminatori dhe Transfer filmi duhet të jenë origjinal (të ofrohen dëshmi)." OE nuk ka dëshmuar se ka ndonjë lidhje që dëshmon partneritetin me prodhuesin e artikujve të kërkuar dhe se artikujt do te jenë origjinal.

OE i përzgjedhur fitues nga AK ELTING-EL nuk e ka përmbushur kërkesën e "Mirëmbajtje e Printerëve Zebra ZXP series 8" OE, nuk ka dëshmuar se ka ndonjë lidhje që dëshmon se ka staf të certifikuar apo të trajnuar për të bërë riparimin apo mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*